



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:262272  
Datë: 06.08.2024  
Numri i dokumentit: 06023467

P.nr.159/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, në çështjen penale kundër të pandehurit L.H. nga fshati ... komuna e Mitrovicës, tani me vendbanim në fshatin ..., rr. "...", për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së si dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 167 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.325/22 e datës 05.07.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 16.07.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori e Shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri L.H. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av.Rifat Bllata, më datë 16.07.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 06.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: L.H. nga i ati A..., e ëma R..., e gjinisë C..., i lindur më datë ... në fshatin ... në Mitrovicë, tani me vendbanim në fshatin ..., rr. "...” nr..., komuna e Vushtrrisë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon jashtë vendit në instalim dhe mirëmbajtje të rrjetit kompjuterik, i martuar, prind i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I. SEPSE: Prej datës dhe vitit të pa përcaktuar e deri më 31.08.2022, rreth orës 13:05, në rrugën "...” në Vushtrri, në shtëpinë e tij në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët (Ligji nr.05/L-22), pa autorizim ka poseduar pistoletë me gaz e llojit “Walther P.99”, ngjyrë e zezë, e kalibrit 9 mm, PAK, me numër serik B54780558, një karikator dhe tre (3) fishek të asaj arme, të cilat janë gjetur dhe sekuestruar nga policia,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

II. SEPSE: Me datën 31.08.2022, rreth orës 13:03, në rrugën “...” në Vushtrri, në oborrin e shtëpisë së tij përdorë armën në kundërshtim me ligjin për armët (Ligji nr.05/L-22), në atë mënyrë që duke qenë në një aheng familjar pa autorizim ka përdorur pistoletën me gaz të llojit “Walther P.99”, ngjyrë e zezë e kalibrit 9mm Pak me numër serik B54780558 dhe me të njëjtën kishte shtënë dy herë,

- Me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72, 366 par.1, par.3 dhe 367 par.1 KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364 dhe 449 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

Të pandehurin L.H.:

Për pikën I të dispozitivit i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej tetëqind (800) euro, e që i njëjti do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për pikën II të dispozitivit DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej katër (4) muaj.

Me pëlqimin e te pandehurit e ne vështrim te dispozitave te nenit 44 te KPRK-së dënimi me burgim te pandehurit i zëvendësohet ne dënim me gjobë në shumën prej tetëqind (800) euro.

Ne vështrim te dispozitave te nenit 76 te KPRK-së, te pandehurit gjykata i shqipton:

## DENIM UNIK ME GJOBË

Me te cilin te pandehurit gjykata i shqipton dënimin unik me gjobë ne shumen prej 1600€ (njëmijegjashtëqind euro). Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

URDHËROHET- Konfiskimi i përhershëm i pistoletë me gas e llojit “Walther P.99”, ngjyrë e zezë, e kalibrit 9 mm, PAK, me numër serik B54780558, një karikator dhe tre (3) fishek të asaj arme.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

*Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.325/22 e datës 05.07.2019, kundër të pandehurit L.H. nga fshati ... komuna e Mitrovicës, tani me vendbanim në fshatin ..., rr. "...", komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Mbjajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

*Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më dt.16.07.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që:

I pandehuri L.H. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë dhe i premtton gjykatës që në të ardhmen kjo veprë nuk do të përsëritet më.

*Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë, gjykatës i propozon që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa si dhe rrethanat rënduese shkallën e lartë të dashes në drejtim të kryerjes së veprës penale, marrë parasysh faktin se i njëjti përveç që ka poseduar armën pa leja nga institucioni i njëjti ka shtënë më shumë se një herë dhe atë në aheng familjar, ku pritet të ketë shume persona dhe ka mundur të shkaktojë rrezik për gjithë ata persona, po ashtu prokurori i shtetit i propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidencat penale dhe nga ajo rezulton të mirët si rrethanë lehtësuese eventualisht rënduese. Po ashtu prokurori i shtetit qëndron pranë propozimit konform dispozitave të nenit 366 par.3 që të konfiskohet arma, një karikator dhe tre fishek.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim av. Rifat Bllata lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë, por siç deklaroi edhe tani nuk ka qenë në dijeni se nja armë e tillë me gaz është e ndaluar mbajtja dhe përdorimi i saj, andaj ka shtënë në ajër, por duke pasur parasysh se një armë e tillë siç është përshkruar dhe e sekuestruar është e tipit me gaz, nuk ka paraqitur rrezik për pjesëmarrësit që kanë qenë prezent dhe i njëjti ka shprehur keqardhje dhe pendesë për atë që ka ndodhur me premtimin se asnjëherë në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme. Jeton dhe punon jashtë vendit që 32 vite, asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin dhe duke marrë parasysh rrethanat se i njëjti ka shtënë në dasmën e djalit në shenj të gëzimit pa e njohur mirë ligjin në Kosovë, ka ardhur deri të ky rast dhe i njëjti në gjykatë shpreh pendesën dhe kërkon falje për atë që ka bërë, kurse unë

si mbrojtës i propozojë gjykatës që e njëjta ti merr parasysh të gjitha këto rrethana, bashkëpunimin e plotë në prokurori dhe gjykatë si dhe paraqitjen vullnetare në momentin e kur ka mësuar së ka këtë lëndë.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Raport fillestar i incidentit numër të rastit 2022-BD-697, i datës 31.07.2022, Raport i policit, i datës 31.07.2022, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin L.H., i datës 31.07.2022, Raport i shpejtë, i datës 31.07.2022, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, i datës 01.08.2022, Fotoalbumi i përbërë nga 6 foto, Lista e dëshmimeve nga njësia e forenzikës, i datës 01.08.2022.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

Ndërsa neni 367 par.1 i KPRK-së përcakton formën themelore të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm “*Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.*”

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69, 70, dhe 71 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese,

kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale. Sa iu përket rrethanave renduese gjykata si rrethane renduese ka vlerësuar shkallen e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës se mbrojtur ndërkaq rrethana tjera renduese gjykata nuk ka gjetur.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat (rënduese dhe lehtësuese) të cekura më lartë, ka vlerësuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për aplikim të dispozitave për zbutjen e dënimit nga 71 i KPRK-së i cili parasheh se, *“Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: 1.1. kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet; 1.2. kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; ose 1.3. në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.”* dhe 72 par.1, pika 1.5 në të cilin edhe parasheh *“Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: 1.5: nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim;”*.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi unik me gjobë në shumë prej 1600 (një mijë e gjashtë qind) euro për pikën I dhe për pikën II të dispozitivit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Urdhërin për konfiskimin e armës gjykata e ka marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se *“Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2022:262272  
Datë: 06.08.2024  
Numri i dokumentit: 06023467

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.159/2024, datë 06.08.2024

Zyrtarja ligjore  
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Ferki Xhaferi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.